



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PËRMET
KËSHILLI VENDOR RINOR

Datë 11/11/2025

PROCES VERBAL

Mbledhja e parë e Këshillit Vendor Rinor Përmet

Vendi : Qendra Rinore, Përmet

Ora : 13:00

Tema e mbledhjes : Prezantimi i anëtarëve të Këshillit Vendor Rinor dhe përcaktimi i objektivave të realizuara në Planin Vendor të Rinisë 2020-2023 Bashkia Përmet.

I mbajtur sot më datë 11 Nëntor, pranë ambienteve të Qendrës Rinore. Të pranishëm në këtë mbledhje ishin Drejtor i Projekteve të Huaja znj. Klaudja Ciko, Përfaqësuese e Shoqatës Multifunkionale për Kulturë, Edukim dhe Zhvillim znj. Loreta Mamani, Ekspertja e Shoqatës Multifunkionale për Kulturë, Edukim dhe Zhvillim znj. Albana Allushaj, Specialist i Turizmit dhe Rinisë znj. Kristiana Thodhori dhe anëtarët e Këshillit Vendor Rinor.

Takimi u hap nga Drejtoresha e Projekteve të Huaja, e cila fillimisht përshëndeti të gjithë të pranishmit dhe prezantoi anëtarët e Këshillit Rinor me përfaqësueset e Shoqatës. Ajo theksoi rëndësinë e këtij bashkëpunimi si një mundësi reale që të rinjtë të kenë zë në proceset e vendimmarrjes lokale. Gjithashtu vuri në dukje se Këshilli Rinor synon të bëhet një urë komunikimi midis të rinjve dhe institucioneve vendore, duke propozuar ide konkrete që lidhen me arsimin, punësimin, mjedisin dhe zhvillimin kulturor. Shoqata MKEZH është shoqata fituese në thirrjen e VIII-të të Bashkisë Përmet Programi Reload2. Prioriteti I thirrjes ishin të rinjtë e Përmetit, përfshirja dhe bashkëpunimi sa më i ngushtë me këtë target grup.

Më pas morën fjalën përfaqësueset e “Shoqatës Multifunkionale për Kulturë, Edukim dhe Zhvillim”, të cilat prezantuan eksperiencën e tyre dhe punën me të rinjtë. Ato theksuan mënyrën se si hartohet plani vendor për rininë, duke shpjeguar hapat që duhen ndjekur për përfshirjen aktive të të rinjve në të gjitha fazat e tij — nga identifikimi i nevojave, deri te propozimi i nismave konkrete. Gjatë prezantimit, përfaqësueset nënvizuan rëndësinë e analizës së planit paraardhës, për të parë çfarë nuk ka funksionuar, cilat objektiva nuk janë zbatuar plotësisht, dhe çfarë mund të përmirësohet në planin e ri.

Ato propozuan që në mbledhjen e ardhshme të zhvillohet një diskutim i detajuar mbi këto pika, në mënyrë që Këshilli Rinor të kontribuojë me sugjerime të qarta dhe të dobishme për përmirësimin e dokumentit strategjik.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PËRMET
KËSHILLI VENDOR RINOR

Gjatë takimit, anëtarët e këshillit shprehën gatishmërinë për t'u përfshirë aktivisht në këtë proces dhe ndanë disa ide fillestare lidhur me sfidat që hasin të rinjtë në komunitet.

Gjatë diskutimeve, anëtarja e Këshillit Esmeralda Metko, pjesëmarrja e së cilës u realizua online nëpërmjet platformes Zoom, ndau eksperiencat e saj personale nga pjesëmarrja në projekte të ngjashme rinore. Ajo theksoi se angazhimi aktiv i të rinjve në nisma konkrete e bën më të lehtë identifikimin e problemeve që prekin moshën e tyre. Gjithashtu ajo ishte e gatshme të ofronte ndihmën e saj nëpërmjet trajnimeve të ndryshme për të rinjtë, kjo si rezultat i pjesëmarrjes së saj aktive në aktivitete të shoqatave të ndryshme si dhe eksperiencës së përditshme pranë këtyre shoqatave. Ajo u shpreh e gatshme për të ofruar ndihmë për të rinjtë e qytetit për aktivizimin e tyre dhe fitimin e eksperiencave të reja.

Në përfundim, palët u dakordësuan të bashkëpunojnë ngushtë me shoqatën partnere për të përgatitur një material analitik mbi planin ekzistues dhe për të përmbledhur propozime konkrete që do të diskutohen në takimin vijues.

Takimi u mbyll më **15:30**.

Specialisti i Turizmit dhe Rinisë

Kristiana Thodhori

Anëtarë të Këshillit Vendor Rinor Përmet





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PËRMET
KËSHILLI VENDOR RINOR

Foto nga takimi:

